



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-004

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KOOPERATIVAT E
BUJQËVE NR. 2003/9**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të nenit 65, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

Duke pasur parasysh nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit NR. 2003/9 për Kooperativat e Bujqve i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut NR. 2003/21 të datës 23 qershor 2003, për krijimin e kushteve për zbatimin e tij,

Miratton këtë

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KOOPERATIVAT
E BUJQËVE NR. 2003/9**

Neni 1

Neni 1 Definicioni: ”Federata” ndryshohet si vijon:
”Federata është bashkim vullnetar i disa kooperativave bujqësore”.

Neni 2

Neni 2 paragrafi 5 fshihet teksti: ”të gjitha kooperativave ekzistuese dhe”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si vijon: fshihet “dhjetë bujq” dhe bëhet ”pesë bujq”.

Neni 4

Neni 7.3 pika a) dhe b) riformulohen, si vijon :
“Statusi i anëtarit të ri të kooperativës fitohet pas aprovimit të kërkesës nga organi kompetent i kooperativës, me të gjitha të drejtat dhe obligimet e anëtarit të kooperativës.”

Neni 5

Neni 10 paragrafi 4 fshihet teksti ”mbledhja e jashtëzakonshme”.

Neni 6

Neni 21 paragrafi 1 fjala “delikt ekonomik” zëvendësohet me “kundërvajtje”,

Paragrafi 2 i nenit 21 riformulohet si vijon: Me dënim me gjobë prej 3000-5000 do të dënohet për kundërvajtje kooperativa e bujqve nëse ushtron veprimtari të cilat nuk janë të parapara në statutin e saj dhe për të cilat nuk është e regjistruar (neni 2.2),

Shtohet paragrafi i ri 21.3 si vijon: Me dënim me gjobë prej 1000-3000 euro dënohet për kundërvajtje kooperativa e bujqve nëse:

- a) në emërtimin e firmës së vet nuk e shfrytëzon emrin e kooperativës dhe
- b) nëse nuk mban regjistrin e anëtarëve të kooperativës (neni 7.3).

Shtohet paragrafi i ri 21.4 si vijon: Mjetet e realizuara nga pagesa e dënimeve për shkelje të dispozitave të këtij ligji derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.”

Neni 7

Neni 23 titulli “Dispozitat kalimtare” fshihet.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-004
3 tetor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI